



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT
SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY

MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE
NAUKU I TEHNOLOGIJU

Kabineti i Ministrit

Minister's Cabinet

Kabinet Ministra

08 tetor 2007

Për të nderuar veprën dhe angazhimit profesional të kolegut Maxhun Tishuku, MASHT mbajti Mbledhje Komemorative

Pas një sëmundje të shkurtër në moshën 57 vjeçare ndërroi jetë kolegu ynë Maxhun Tishuku

Veliu: Maxhuni ishte mishërim i punës së mësimdhënësit dhe veprimtarit për vizionin e lirisë së Kosovës



Në Mbledhjen Komemorative Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë përkujtoi veprën dhe angazhimin profesional të kolegut dhe bashkëpunëtorit tonë Maxhun Tishuku

Maxhuni ishte dhe mbetet përjetësisht shembull i njeriut të urtë, i punës së palodhshme për arsimin e Kosovës, simbol i sakrificës për punën shumëvjeçare dhe i përkushtimit për lirinë e pavarësinë e vendit tonë. Ai ishte i mishëruar me punën e mësimdhënësit të gjuhës së bukur shqipe. Si 18 vjeçar Maxhuni punoi palodhshëm për t'i pajisur nxënësit e breznitë me dije për gjuhën dhe letërsinë shqipe, për ëndrrën dhe vizionin e lirisë për shqiptarët. Ai, edhe gjatë punës së tij, këtu në MASHT, ishte punëtor i devotshëm e fjalë pak, por i dashur dhe i afërt me të gjithë kolegët edhe me ata në komunat e Kosovës me të cilët bashkëpunoi për mbarëvajtjen e mësimin kudo në Kosovë, kështu filloi të kujtoj punën e kolegut dhe bashkëpunëtorit tonë, Ministri Agim Veliu. E më pas Ministri Veliu kujtoi se: Maxhuni ishte pjesëmarrës i demonstratave të 68-tës, mësimdhënës i përkushtuar i gjuhës shqipe, themelues i degës së LDK-së në Deçan, udhëheqës i arsimit deçanas në dhjetëvjeçarin e ndërtimit të Republikës së Kosovës, por edhe pjesëmarrës aktiv i luftës së fundit. Por Maxhuni gjithnjë mbeti ideator dhe njeri i rrugës institucionale për ndërtimin e shtetit të pavarur të Kosovës.

“Në kohën kur LDK e propozoi për deputet në Parlamentin e ardhshëm dhe kur NE pritëm angazhimin e tij në institucionet e Kosovës së pavarur për të cilat AI dha shumë, vdekja e ndau nga familja, nga ne dhe miqtë, nga Kosova çfarë Maxhuni e pa herët në vizionin e tij! Dhembja është e natyrshme në këto çaste për familjarët dhe të gjithë në kolegët e Maxhunit. Por NE jemi krenarë që në mesin tonë patëm një njeri, mësimdhënës, bashkëpunëtor dhe intelektual si Maxhuni”, tha Ministri Veliu.

Në mbyllje të Mbledhjes Komemorative, Ministri Veliu, në emër të tij, të kolegëve dhe të të gjithë komunitetit arsimorë dhe akademik i dërgoi ngushëllimet e sinqerta familjes Tishuku dhe miqve e bashkëpunëtorëve.

Me nderime të larta u varros kolegu ynë Maxhun Tishuku

MASHT i tha lamtumirën e fundit zyrtarit Maxhun Tishuku

Maxhuni ishte dhe mbetet përjetësisht shembull i njeriut të urtë, i punës së palodhshme për arsim, simbol i sakrificës, dhe i përkushtimit për lirinë e pavarësinë e Kosovës, tha Ministri Agim Veliu në ceremoninë e varrimit në fshatin Isniq të Deçanit

Dje në ceremoninë mortore të kolegut Maxhun Tishku, Ministri Avgim Veliu pasi që në emër të MASHT-it u shprehu ngushëllime familjes Tishuku, më pas me një fjalë përkujtimore foli për veprën dhe angazhimin profesional të Maxhunit.

“Maxhuni ishte dhe mbetet përjetësisht shembull i njeriut të urtë, i punës së palodhshme për arsim, simbol i sakrificës si dhe i përkushtimit për lirinë e Pavarësinë e Kosovës. Ai, qysh i ri punoi palodhshëm për t’i pajisur nxënësit e breznitë me dije për gjuhën dhe letërsinë shqipe, për ëndrrën dhe vizionin e lirisë për shqiptarët”, tha Ministri Veiliu në fjalën përkujtimore për Maxhunin.

Gjatë punës në MASHT, Maxhuni ishte punëtor i devotshëm e fjalëpakë por i dashur dhe i afërt me të gjithë kolegët. Ai punoi e bashkëpunoi me komunat e Kosovës për mbarëvajtjen e mësimit kudo në Kosovë si dhe realizoi projekte të rëndësishme edhe me partnerë e miq ndërkombëtarë të arsimit kosovar, tha Veliu.

Ngushëllime familjes Tishuku u shprehu edhe Zëvendës Ministri Fevzi Berisha dhe tha se të gjithë ne që patëm fatin ta njohim veprën e Maxhunit mburremi me te. “Që në moshën e re Maxhuni kyçet në edukimin dhe arsimimin e brezave të rinj por njëkohësisht edhe në rezistencën paqësore kundër ish pushtetit të atëhershëm sidomos për mbrojtjen e shkollës shqipe dhe në edukimin e të rinjve në baza patriotike”, tha z.Berisha. Më pas, z. Berisha kujtoi se Maxhuni në vitet 90 së bashku me veprimtar tjerë ishte themelues i arsimit të pavarur për komunën e Deçanit ndërkaq, në vitin shkollor 2003/2004 në cilësinë e kordinatorit për bashkëpunim me arsimin komunal fillon veprimtarin në MASHT në të cilin aktivitet ishte deri në momentet e fundit të jetës.

Në kujtim të Maxhunit, në emër të bashkëfshatarëve foli Mehmet Bojku, Kryetarë i Degës së LDK-së në Isniq. Z. Bojku ndër të tjera tha se Maxhun Tishuku ishte njeri i modest, i guximshëm dhe atdhetarë i devotshëm, njeri që me tërë çejnën u angazhua për Pavarësinë e Kosovës.

Maxhun Tishuku u varros me nderime të larta në fshatin Isniq të komunës së Deçanit.

Ministri Agim Veliu u takua me përfaqësuesit e SBASHK-ut



Ministri Agim Veliu sot u takua me përfaqësuesit e SBASHK-ut. Në këtë takim delegacioni i SBASHK-ut i udhëhequr nga kryetari i saj z. Ali Shabani paraqiti kërkesën e tyre që në kuadër të rritjes së pagave të arsimtarëve prej 12% të përfshihen edhe punëtorët administrativ dhe teknik.

Ministri Veliu i njoftoi të pranishmit se edhe pas angazhimit maksimal që është bërë deri më tani për të krijuar të ardhura më të mira për kuadrin arsimor në vend, MASHT ka arritur të realizoj vetëm ngritjen e pagave të mësimitdhënësve 12 %. “Edhe pse kjo është një ngritje e vogël, MASHT shpreson që sadopak do të arrijë të lehtësoj gjendjen e vështir sociale të mësimitdhënësve”, tha Ministri Veliu. Po ashtu, Veliu i njoftoi të pranishmit se për shkak të kufizimeve të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës si dhe të kufizimeve që ka vënë Fondi Monetar Ndërkombëtar, në këtë rritje nuk mund të përfshihen edhe punëtorët administrativ dhe teknik. Pagat e këtyre punëtorëve do shqyrtohen bashkë me pagat e rreth 50 mijë shërbyesve tjerë civil të Kosovës.

Çështje tjetër që u shtrua në këtë takim ishte edhe licencimi i mësimitdhënësve për të cilën gjithë Ministri Veliu i njoftoi përfaqësuesit e SBASHK-ut se MASHT ka bërë të gjitha përgatitjet për të filluar me këtë proces që është i rëndësishëm kapitalë për arsimin në Kosovë. Për këtë arsye MASHT tani ka miratuar Udhëzimin Administrativ për Licencimin si dhe ka caktuar grupin punues që është duke punuar në hartimin e rregullave për licencimin e mësimitdhënësve, sqaroi Veliu.

U mbajt aktiviteti përmbyllës për projektin “Promovimi i Procesit të Bolonjës në Kosovë”, i implementuar nga MASHT në bashkëpunim me Universitetin e Lubjanës dhe Universitetin e Peleponezit

Procesi i Bolonjës , proces integruar që hap dyert e Kosovës për t`u bërë pjesë e Evropës së Bashkuar

Kontributi më i madh për realizimin e projektit është mobilizimi i komunitetit akademik në Kosovë mbi Procesin e Bolonjës. MASHT dhe UP prej viti në vit kanë rritur numrin e studentëve, por MASHT dhe Qeveria e Kosovës kërkojnë sigurimin e cilësisë dhe arritjen e standardeve sipas Procesit të Bolonjës. Arsimit është shumë i rëndësishëm për të ardhmen e vendit dhe ai duhet të jetë më konkurrues, për të qenë pjesë e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë dhe pjesëmarrës në garën dhe nivelin e dijes që kërkon koha dhe teknologjitë e reja të shekullit XXI, tha Ministri Agim Veliu në aktivitetin përmbyllës për projektin “Promovimi i Procesit të Bolonjës në Kosovë”

Rrugëtimin për t`u anëtarësuar në Procesin e Bolonjës, Kosova e ka filluar menjëherë pas lufte. Pikënisja e këtij rrugëtimi është viti akademik 2001/2002 kur në Universitetin e Prishtinës është implementuar sistemi i studimeve 3+2+3. Po në këtë kohë ka filluar edhe implementimi i Sistemit Evropian për Transferin dhe Akumulimin e Kredive (ECTS). Pastaj, Ligji për Arsimin e Lartë i miratuar në vitin 2003 është në përputhje me objektivat e Procesit të Bolonjës. Një dëshmi tjetër e jona që ne jemi për integrim në Procesin e Bolonjës është edhe përgatitja dhe aprovimi i Strategjisë për Arsimin e Lartë 2005/2015. Ndërkaq rekomandimet e Berlinit, të Bergenit e tashmë edhe të Londrës janë shndërruar në objektiva të MASHT për ngritjen e cilësisë dhe zhvillimet tjera në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë. Edhe pas të gjitha këtyre zhvillimeve pozitive, Kosova ende nuk është pranuar si anëtare në Procesin e Bolonjës edhe pse kemi aplikuar në vitin 2005 edhe 2007, tha Ministri Agim Veliu në këtë aktivitet. Më pas Veliu shtoi se: “pengesa kryesore për mospranimin e Kosovës në këtë Proces, na është thënë, është çështja e pazgjidhur e statusit të Kosovës. Mirëpo, shpresoj se kjo pengesë do të tejkalohet pas datës 10 dhjetor kur duhet të mbyllet procesi negociator mbi të ardhmen e Kosovës”.

Megjithatë, Ministri Veliu tha se ruan besimin se përkushtimi i studentëve të Kosovës për studime cilësore, sakrifica e tyre në rrugëtimin për të qenë pjesë e dijes dhe shkencës në rajon dhe më gjerë, është e gatshme gjithmonë për të marrë përgjegjësi karshi zhvillimeve politike dhe ardhmërisë së vendit, po bën që studentët – rinia e Kosovës, të meritojnë që të janë pjesë e progresit evropian e botëror në fushën e arsimit, dijes e shkencës.

“Projekt mbi promovimin e Procesit të Bolonjës në Kosovë, të cilin sot po e përmbylim, i ka dhënë një shtytje të madhe përpjekjeve tona për integrim në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë. Përmes këtij projekti janë zhvilluar vizita studimore të mësimit mësimdhënësve dhe zyrtarëve të Ministrisë të Arsimit në vendet partnere në projekt për të parë përvojat e tyre dhe mësimet që mund të nxirren. Janë organizuar konferenca ndërkombëtare dhe takime të tjera në Prishtinë ku kanë marrë pjesë ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë.

Në funksion të informimit të komunitetit akademik e shkencor me Bolonjën dhe vlerat e një procesi aq të rëndësishëm, është punuar në publikimin e shtyllave kryesore të Bolonjës duke prezantuar dokumente e materiale të nevojshme për Bolonjën, Lisbonën, Pragën, Berlinin, Bergenin, Londrën”, bërë të ditur Ministri Veliu.

Me këtë rast Veliu ju bëri thirrje gjithë stafit akademik të arsimit të lartë në Kosovë që këtë mobilizim ta vazhdojnë edhe më tutje në funksion të përmirësimit të cilësisë dhe efikasitetit të Arsimit të Lartë. Ndërkaq, falënderoj Komisionin Evropian për përkrahjen e projekti, universitetet partnere në këtë projekt, Universitetin e Lubjanës dhe Universitetin e Peloponezitet që me ekspertizën e tyre kanë ndihmuar në implementimin e tij si dhe Grupin e Promotorëve të Procesit të Bolonjës për punën e tyre shumë të vyeshme në organizimin dhe implementimin e këtij projekti.

Në këtë aktivitet, Rektori i Universitetit të Prishtinës Enver Hasani, tha se UP është i privilegjuar dhe i nderuar që është pjesëmarrës në këtë projekt dhe tani në përmbylljen e aktivitetit të tij. Hasani tha se studentët e UP-së falë angazhimit dhe përkushtimit të tyre në fusha të ndryshme të Arsimit të Lartë e meritojnë të jenë pjesë e progresive evropiane dhe atyre botërore, andaj me këtë rast i përgëzoj grupin e Promotorëve të Bolonjës për punën dhe rezultatin e arritur.

Punën e Grupit të Promotorëve të Bolonjës, e përgëzoj edhe përfaqësuesja e Komisionit Evropian Federica Domani dhe tha se Procesi i Bolonjës ka shënuar përparim në arsimin e lartë dhe në perspektivën e tij.

Ndërkaq, Koordinatorin e Grupit për Promovimin e Procesit të Bolonjës Dugagjin Pupovci, tha se përmes këtij projekti deri tani janë organizuar disa seminare dhe janë zhvilluar katër dokumente politike e që janë: zhvillimin i kurrikulave në arsimin e lartë në Kosovë, Implementimin e ECTS në arsimin e lartë në Kosovë, Vlerësimin e institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë, njohjen dhe krahasueshmërinë e diplomave dhe të programeve studimore të para-Bolonjës dhe të Bolonjës, tha z. Pupovci.

Koordinatorin e Projektit Nexhmi Rudari tha se në bazë të këtyre politikave MASHT do të merr masa të nevojshme siç janë përgatitja e udhëzimeve administrative për zbatimin në praktikë të këtyre dokumenteve.

Të gjitha këto dokumente të rëndësishme tanimë janë të aprovuara, të përgatitura me pjesëmarrje të gjerë të komunitetit akademik dhe ekspertëve të fushave përkatëse të cilat do të ndihmojnë Ministrinë e Arsimit në avancimin dhe integrimin e Arsimit të Lartë në Kosovë në rrjedhat arsimore evropiane.

Në kuadër të këtij projekti janë botuar edhe broshura, fletëpalosje edhe materiale të nevojshme me qëllim që stafi akademik dhe qytetarët të njoftohen me ecurinë e Procesit të Bolonjës.

16 tetor 2017

Ministri Agim Veliu do të qëndroj në Vjenë për një vizitë dy ditore

Me ftesën e Ministrit të Arsimit dhe Teknologjisë të Austrisë Johhanes Hahn Ministri Veliu nesër udhëton për në Vjenë

Në krye të një delegacioni të MASHT, Ministri Agim Veliu nesër do të udhëtoj për në Vjenë me qëllim të rishikimit të ecurisë së programit operues për implementimin e partneritetit institucional në mes Austrisë dhe Kosovës në fushën e Arsimit të Lartë, kërkimeve dhe Inovacioneve

Programi për partneritet institucional në mes Austrisë dhe Kosovës ka për qëllim të reformoj dhe stabilizoj sistemin e arsimit të lartë në Kosovë duke ju mbështetur parimeve të Deklaratës së Bolonjës, për këtë arsye i kontribuon objektivit të përgjithshëm për themelimin e një sistemi të mirë qeverisës në Kosovë e që është i drejtuar drejt vlerave dhe standardeve evropiane.

Përmbajtja e Projektit në fjalë vjen si burim i disa takimeve të mëparshme, kërkimeve të brendshme dhe të jashtme si dhe të shkëmbimit të komunikimit në mes palëve me interes të Kosovës dhe Austrisë. Akti më i lartë i këtij rezultati bashkëpunues është Memorandumi i Mirëkuptimit në mes të Austrisë dhe Kosovës i nënshkruar nga Ministria Federale e Austrisë për Marrëdhënie të Jashtme dhe Ministria Federale e Austrisë për Arsim, në njërën anë dhe në anën tjetër UNMIK-u dhe MASHT-i. Të gjitha palët nënshkruese janë pajtuar që të mbështesin programin operues duke kontribuar përmes të hyrave financiare dhe duke bartur njohuritë adekuate përmes burimeve institucionale. Palët nënshkruese dhe ADA kanë themeluar bordin udhëheqës i cili mbikëqyr, diskuton dhe udhëheq implementimin e programit operues dhe komponentët tjerë. E tëra kjo është e ndërtuar përmes punës së bordit drejtues dhe ADA-së e cila do të mbështes MASHT-in në koordinimin e donacioneve në fushën e arsimit të lartë.

Programi operues në fjalë ka një komponentë të fuqishëm për zhvillimin institucional e cila influencon pjesërisht tërë ndërtimin e sistemit të Arsimit të Lartë në Kosovë, p.sh përmes Agjensionit për Akreditim apo Këshillit për Kërkime të Kosovës.

Ndërkaq, udhëtimi i Ministrit Veliu dhe delegacionit të MASHT-it për në vjenë i cili realizohet me ftesë të Ministrit të Arsimit dhe Teknologjisë së Austrisë, Johhanes Hahn, ka për qëllimin rishikimin e ecurisë së procesit të programit operues për implementimin e partneritetit institucional në mes Austrisë dhe Kosovës në fushën e Arsimit të Lartë, kërkimeve dhe Inovacioneve.

Gjatë vizitës dy ditore në Vjenë, Ministri Veliu do të marrë pjesë në dy tryeza të rrumbullakëta. Në tryezën e parë e cila do të mbahet me përfaqësuesit e këshillit drejtues të programit, do të diskutohet për ecurinë e programit operues, ndërkaq në tryezën e dytë do të diskutohet për çështjen e njohjes së diplomave dhe thirrjeve akademike me përfaqësuesit e cila do të mbahet me përfaqësuesit e Ministrisë së Shkencës dhe Kërkimeve të Austrisë, bëri të ditur anëtari i këshillit të programit, Nexhmi Rudari.

Gjatë kësaj vizite, Ministri i Arsimit dhe Teknologjisë të Austrisë, Johhanes Hahn, do të shtrojë një darkë të veçantë për dhe Ministrin Agim Veliu dhe delegacionin e MASHT.

MASHT u takua me drejtorët komunal të arsimit për të diskutuar për gjendjen në arsim pas grevës së SBASHK- ut

Në mbledhjen e Drejtorëve Komunal të Arsimit dhe zyrtarëve të lartë të MASHT të gjithë ishin të pajtimit se mësimin në shkolla duhet të mbahet sipas planprogramit mësimor, ndërkaq ata të cilët nuk i kryejnë detyrat e tyre të parapara sipas planprogramit do ta bartin përgjegjësinë për ndërprerje të mësimi

Dje, në mbledhjen e drejtorëve komunal të arsimit dhe zyrtarëve të lartë të MASHT u diskutua për dy çështje. Si pikë e parë për të cilën u fol në këtë takim ishte situata e krijuar në arsim pas fillimit të grevës, ndërkaq në pikën e dytë u diskutuan dhe u shqyrtuan mundësit për zgjidhjen e dilemave që janë krijuar në disa shkolla.

Gjatë diskutimit të pikës së parë të gjithë të pranishmit ishin të pajtimit se mësimi në shkolla duhet të mbahet sipas planprogramit mësimor për vitin shkollor 2007/2008, ndërkaq ata të cilët do t'i kryejnë obligimet e punës, do ta bartin përgjegjësinë e plotë për moskryerjen e detyrave të parapara në planprogram.

Me këtë rast, Zëvendës Ministri i Arsimit Fevzi Berisha kërkoi nga të pranishmit që kuadri arsimor me përpikëri të respektoj orarin mësimor dhe në këtë mënyrë mësimi të mbahet sipas planprogramit të paraparë për këtë vit. "SBASHK-u i ka aktivitetet e veta për të cilat edhe MASHT është e interesuar që ta zgjidh problemin, mirëpo duhet të kemi parasysh që mundësit tona janë të kufizuara në këtë rast", tha z. Berisha.

Në këtë takim, Sekretari Permanent Fehmi Ismaili i njoftoi drejtorët komunal të arsimit se: "MASHT ka bërë përpjekje maksimale që pagat e mësimdhënësve të ngritën për 12%, ndërkaq për ngritjen e pagave të pjesës tjetër të punëtorëve administrativ MASHT vazhdon të bëjë përpjekje, mirëpo mundësit tona janë të kufizuara". Për këtë arsye MASHT vazhdon të shqyrtoj kërkesat e sindikalistëve dhe t'i realizoj ato brenda mundësive që ka, tha z. Ismaili.

Ndërkaq, drejtorët komunal të arsimit edhe pse shprehën shqetësimin e tyre lidhur me situatën e krijuar në arsim ata unanimisht thanë se janë të pajtimit që mësimi në shkolla duhet të vazhdoj pa asnjë ndërprerje dhe mësimdhënësit do të vazhdojnë të respektojnë planprogramin mësimor.

Në fund të këtij takim zv.Ministri Berisha dhe S.P Ismaili, kërkuan nga DKA, që sot të mbajnë mbledhje me drejtorët e shkollave dhe t'i njoftoj ata se mësimi duhet të mbahet sipas planprogramit të përgatitur për këtë vit shkollor. Po ashtu drejtorët komunal i njoftuan zyrtarët e lartë të MASHT që ecuria e procesit mësimorë në shkolla monitorohet çdo ditë në secilën komunë.

Vizitë e suksesshme për forcimin e partneritetit Austri – Kosovë

Implementohet me sukses projekti austriak në vlerë prej 3 milionë euro për zhvillimin e arsimit të lartë dhe të shkencës në Kosovë

Përmes këtij projekti, Qeveria Austriake do të shpenzojë rreth 3 milion Euro në krijimin e kapaciteteve për punë efikase të Agjencisë të Akreditimit të Kosovës, krijimin e qendrës për transfer të teknologjisë, krijimin e qendrës për hulumtime shkencore, pastaj investimi në binjakëzimin e fakulteteve të Universitetit të Prishtinës me fakultete të ngjashme në Austri, programi i bursave dhe ndërtimi i kapaciteteve të MASHT e të Universitetit të Prishtinës

Me ftesë të Ministrit Federal për Shkencë dhe Teknologji të Austrisë z. Johannes Hahn, më datë 17 dhe 18 tetor 2007, Ministri Veliu bashkë me një delegacion nga MASHT zhvilloi një vizitë në Austri. Vizita u zhvillua me qëllimi të rishikimit të zhvillimeve në kuadër të projektit që MASHT ka me Qeverinë Austriake për përkrahjen e arsimit të lartë në Kosovë. Meqë, ky projekt është i një rëndësie kapitale për arsimin e lartë dhe shkencën në Kosovë, atëherë MASHT e ministritë austriake po i kushtojnë vëmendje të madhe implementimit të nëntë komponentëve të projektit. Përmes këtij projekti, Qeveria Austriake do të shpenzojë rreth 3 milion Euro në krijimin e kapaciteteve për punë efikase të Agjencisë të Akreditimit të Kosovës, krijimin e qendrës për transfer të teknologjisë, krijimin e qendrës për hulumtime shkencore, pastaj investimi në binjakëzimin e fakulteteve të Universitetit të Prishtinës me fakultete të ngjashme në Austri, programi i bursave dhe ndërtimi i kapaciteteve të MASHT e të Universitetit të Prishtinës. Po ashtu projekti ofron mundësinë që shumë studiues dhe staf nga Universiteti i Prishtinës të kryejnë studime të avancuara të doktoratës në universitete të ndryshme në Austri. Ministri Veliu u shpreh se është mirënjohës për ndihmën e vazhdueshme që Qeveria Austriake ka ofruar për Kosovën. Ai theksoi se ky projekt që po implementohet tani është shumë i rëndësishëm për krijimin e kapaciteteve të institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë për zhvillim të qëndrueshëm dhe afatgjatë. Ajo që është e rëndësishme, u shpreh Ministri Veliu gjatë diskutimeve me partnerët austriakë, është se institucionet e Kosovës po marrin rol prijës në projekte të rëndësishme të reformimit dhe zhvillimit të institucioneve arsimore dhe shkencore në Kosovë. Ministri Federal për Shkencë dhe Teknologji i Austrisë, z. Johannes Hahn u shpreh i kënaqur me rrjedhën e projektit deri më tani dhe konfirmoi përkushtimin e Qeverisë së tij në këtë drejtim. Ai po ashtu mbështeti idenë për zgjerimin e këtij bashkëpunimi edhe në fusha të tjera. Ministri Veliu zhvilloi edhe një intervistë me gazetën e mirënjohur në Austri “Wiener Zeitung” e cila është gazeta më e vjetër në botë. Interesimi i kësaj gazete ishte mbi zhvillimet sa i përket statusit të Kosovës dhe mbi rastin e vajzës nga familja Zogaj. Ministri u shpreh se bisedimet që po zhvillohen momentalisht midis Prishtinës dhe Beogradit me ndërmjetësim të treshes ndërkombëtare do të përmbyllen më date 10 dhjetor dhe pas kësaj do vendoset për statusin përfundimtar të Kosovës në bazë të vullnetit të popullit të Kosovës. “Zhvillimet pozitive në Kosovë gjatë viteve të fundit kanë qenë pozitive në krijimin e kushteve më të mira për jetë dhe prosperitet, por rasti i vajzës

nga familja Zogaj duhet parë si përpjekje individuale për të siguruar dhe jetuar në një vend me standard dhe kushte më të mira të jetesës”, tha Ministri Veliu. Ai përsëriti përkushtimin e Qeverisë së Kosovës për të krijuar kushte për jetesë e punë në Kosovë për të gjithë banorët e saj pa dallim se çfarë përkatësie etnike apo religjioze kanë ata. Në fund dy ministrat vendosën që takimet e përbashkëta të zhvillohen në mënyrë të rregullt për të parë zhvillimin e bashkëpunimit dhe zbatimin e projekteve të përbashkëta në arsim e shkencë.

19 tetor 2007

Zëvendës Ministri Fevzi Berisha priti delegatët e Parlamentit të Shqipërisë, Bosne-Hercegovinës dhe Malit të Zi

Delegatët e Parlamentit të Shqipërisë, Bosne-Hercegovinës dhe Malit të Zi vizituan MASHT-in

Delegacioni i përbërë nga përfaqësues të Shqipërisë, Bosnje-Hercegovinës dhe Malit të Zi, gjatë takimit që patën sot në MASHT u njohën me pikëpamjet ministrore dhe qeveritare të reformës në arsim

Qëllimi i vizitës së parlamentarëve në Kosovë është realizuar në kuadër të programit “Praktika Parlamentare Lindje Perëndim”, në të cilin marrin pjesë parlamentet e Ballkanit perëndimor. Ky program ka për qëllim të zhvillojë bashkëpunim në fusha të ndryshme, theksoi z. Lulzim Beci, përfaqësues i Instituti kosovar për kërkim dhe zhvillim të politikave - KIPRED. Gjatë kësaj vizite parlamentarët e Shqipërisë, Bosne-Hercegovinës dhe Malit të Zi do të njihen me reformat në arsim. Gjatë një tryeze të rrumbullakët, të mbajtur sot në Prishtinë, parlamentarët kanë këmbyer përvojat e veta për çështje të ndryshme.

Zëvendës Ministri i MASHT, Fevzi Berisha pasi i uroi mysafirëve mirëseardhje, theksoi se një vizitë e tillë është shumë e rëndësishme për bashkëpunim të ndërsjellët në mes këtyre vendeve. Më pas, z. Berisha i njoftoi të pranishmit se falë angazhimeve të vazhdueshme të MASHT dhe Qeverisë së vendit sot është ndërprerë greva e organizuar nga SBASHK.

Sa i përket reformës në arsimin kosovar, z. Berisha tha: “MASHT e ka filluar reformimin e sistemit të arsimit menjëherë pas luftës, me sistemin 5+4+3 ose 4, ndërkaq tani e kemi sistemin e obliguar 9 vjeçar, arsimin fillor 5 vjeçar, arsimin e mesëm të ulët 4 vjeçar dhe arsimin e lartë 3 ose 4 vjeçar.

Tani jemi duke zhvilluar edhe mësimin për komunitete në gjuhën boshnjake, turke, kroate që prej nivelit parashkollor deri te arsimit të lartë”, tha z. Berisha. Sa i përket monitorimit të reformave zv. Berisha tha se tani jemi në fazën e monitorimit të tyre, për të cilin proces kemi angazhuar edhe dy Institute: Institutin e Lubjanës dhe atë të Londrës.

Gjithashtu zëvendësministri përmendi edhe përgatitjen e Strategjisë për Arsimin Parauniversitar 2007-2017 si dhe atë të Arsimit të Lartë 2007-2015.

Gjatë vizitës në Kosovë delegatët e Parlamentit të Shqipërisë, Bosne-Hercegovinës dhe Malit të Zi kanë vizituar edhe Universitetin Amerikan në Kosovës, ndërsa do të ketë takime edhe me ministrin e Punëve të Brendshme, z. Blerim Kuçi dhe Rektorin e Universiteti të Prishtinës, z. Enver Hasani.

22 tetor 2007

MASHT dhe UP themeluan Programin për Aftësim dhe Rikualifikim me qëllim të aftësimin dhe rikualifikimit të edukatorëve dhe mësimehdhënësve aktiv

Ministri Agim Veliu dhe Rektori Hasani nënshkruan Memorandumin për Aftësim dhe Rikualifikim të mësimehdhënësve



MASHT dhe UP themeluan Programin për Aftësim dhe Rikualifikim me qëllim të aftësimin dhe rikualifikimit të edukatorëve dhe mësimehdhënësve aktiv (klasorë dhe lëndorë) në sistemin arsimor të Kosovës për t'i plotësuar kërkesat e deklaratës së Blonjës dhe të MASHT në fushën e edukimit, tha Ministri Veliu me rastin e nënshkrimit të Memorandumit

Pas përfundimit të suksesshëm të fazës Pilot I dhe II, të Programit për aftësim pa shkëputje nga puna, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë MASHT dhe Universiteti i Prishtinës – UP, kalojnë në nivelin tjetër në atë të programit të rregullt për aftësimin dhe trajnimin e mësimehdhënësve pa shkëputje nga puna. “MASHT dhe UP themeluan Programin për Aftësim dhe Rikualifikim – PARK, me qëllim të aftësimin dhe rikualifikimit të edukatorëve dhe ,mësimehdhënësve aktiv (klasorë dhe lëndorë) në sistemin arsimor të Kosovës për t'i plotësuar kërkesat e deklaratës së Blonjës dhe të MASHT në fushën e edukimit”, tha Ministri Veliu në ceremoninë e nënshkrimit të këtij Memorandumit.

Më pas Veliu sqaroi se Programi për Aftësim dhe Rikualifikim do të hartoj programe aftësimi dhe kualifikimi deri në shkallën baçellor duke përfshirë edhe kualifikime të ndërmjetme për kandidatët që kanë mbaruar programe për aftësim të mësimehdhënësve por nuk kanë pasur mundësi të punësohen në procesin arsimor dhe atë atyre që kanë mbaruar më shumë se gjysmën e një programi për përgatitje të mësimehdhënësve, por kanë mbetur pa e përfunduar atë.

“Ky program do të funksionojnë sipas tipit të studimit pa shkëputje nga puna dhe do të jetë i autorizuar të ofrojë shkallën e përgjithshme Baçellor i Edukimit për fushën e caktuar lëndore, e cila pranohet nga MASHT si ekuivalente me kualifikimet e ofruara në programin e rregullt të Fakultetit të Edukimit”, tha Ministri Velu.

Ndërkaq, Rektori Enver Hasani, me këtë rast tha se programi për aftësim dhe rikualifikim të mësimit të mësimdhënësve, i themeluar nga MASHT dhe UP ka për qëllim të organizoj mësimit të mësimdhënësve teorike dhe praktike për të plotësuar dhe zhvilluar dijen, kompetencat e përgjithshme dhe specifike lëndore si dhe shkathhtësitë e aftësitë deri në nivelin e kërkuar për të fituar thirrjen baçellor i edukimit sipas standardeve përkatëse evropiane.

Vijuesit e PARK do të jenë në rend të parë mësimit të mësimdhënësve të certifikuar në Kosovë në ndonjërin nga programet universitare dhe parauniversitare për përgatitjen e mësimit të mësimdhënësve.

Mësimit të mësimdhënësve dhe trajnerët e programit për aftësim dhe rikualifikim, do të zgjedhën nga komisionet përzgjedhëse të Këshillit Drejtues për secilin tremestër nga grupi i mësimit të mësimdhënësve të pranuar në listën e mësimit të mësimdhënësve të Programit pas aftësimeve përkatëse sipas kriterëve dhe kërkesave të përcaktuara nga MASHT dhe UP në këtë Memorandum Mirëkuptimi.

Pos këtyre, MASHT dhe UP autorizojnë Programin për Aftësim dhe Rikualifikim që të zgjerojë ofertën e vet në fushën e aftësimit dhe rikualifikimit në funksion të mësimit të mësimdhënësve (arsimit gjatë gjithë jetës).

22 tetor 2007

MASHT në bashkëpunim me AER organizuan punëtorinë treditore lidhur me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve

Përfundoi punëtorja treditore lidhur me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve – KKK

MASHT në bashkëpunim me AER - programi Kosvet ka organizuar një punëtori treditore lidhur me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve, në të cilën morën pjesë zyrtarë të MASHT, ekspertë ndërkombëtarë nga kjo fushë, përfaqësues së organizatave qeveritare dhe joqeveritare dhe partneret social.

Me këtë rast, Zëvendësministri Fevzi Berisha dhe sekretari i përhershëm i MASHT, z. Fehmi Ismaili i uruan punë të mbarë të pranishmëve, ndërkaq Vincent McBride, nga Fondacioni Evropian i Trajnimeve foli për karakteristikat kryesore të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve. John Hart prezantoi Kornizën Skoceze të Kualifikimeve dhe Mike Sell prezantoi përshkrimet e niveleve të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve pra ekspertët ndërkombëtarë dhanë informata lidhur me disa çështje të Kualifikimeve.

Nga puna në grupe e pjesëmarrësve doli si përfundim se KKK e Kosovës duhet të jetë e krahasueshme me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve (KEK).

Në këtë punëtori u tha se duhet të krijohet një grup punues i përbërë nga përfaqësuesit e Grupit të Dublinit, Agjencionit të Akreditimit, partnerët shoqëror dhe bartësit të tjerë, për të punuar më tutje për KKK.

Përshkruesit e niveleve të cilat janë përdorur gjer më tani për zhvillimet e KEK në përgjithësi janë pranuar, megjithëse janë ngritur disa çështje sa i përket përshtatshmërisë për përdorim të ofrimit të arsimit dhe aftësimin jo-formal në nivelin e 5. Puna e mëtejshme që duhet të bëhet për nivelet është se ato duhet të ilustrohen me shembuj, duke i përdorur përshkruesit më të fundit të KEK dhe përshkruesit e Dublinit për Arsimin e Lartë.

Të gjithë bartësit që morën pjesë në punëtori e përkrahën nevojën e miratimit të projektligjit sa më shpejtë që është e mundur.

Ekziston nevoja për punë të mëtejshme lidhur me krijimin dhe miratimin e standardeve të cilat shpijnë në kualifikime.

Ishte nevoja të përcaktohet niveli i 5.

Duhet të themelohet një grup punues në të cilin përfaqësohet arsimit dhe aftësimi formal dhe jo-formal të cilët do të:

- Hulumtojnë se çfarë aktualisht mendohet të jetë niveli i 5 dhe certifikimi i tij
- Tregojnë nevojat e dallueshme në këtë nivel
- Verifikojnë nëse ofrimi i tanishëm i përmbush kërkesat e nivelit V të KEK
- Bëjnë rekomandime për rregullat dhe për institucionet që qeverisin realizimin dhe akreditimin e nivelit 5 të ofruar në KKK.
- *Përfaqësuesit e ETF propozuan që t'i dërgojnë informatat për ti përdorur grupi punues se si është rregulluar niveli i 5 në disa shtete tjera.*

U theksua nevoja të krijohet një qasje e përgjithshme për sigurim të cilësisë për tërë AKK të bazuar në Kornizën e Përbashkët Evropiane të Sigurimit të Cilësisë (KPESC/CQAF)

23 tetor 2007

Ministri Agim Veliu udhëton për në Tiranë

Ministri Veliu merr pjesë në Tryezën mbi arsimin dhe anitkorrupsionin

Tryeza do të mbahet me qëllim shkëmbimi të eksperiencave të vendeve të Evropës Juglindore -EJL në lidhje me masat antikorrupsion në arsim dhe themelimin e një iniciative të përbashkët të vendeve të EJL për masat antikorrupsion

I shoqëruar nga këshilltari i lartë Avdullah Hoti, Ministri Agim Veliu të mërkurën më 24 tetor do të marrë marr pjesë në Tryezën mbi arsimin dhe anitkuorrupsionin që mbahet në Tiranë.

Në këtë tryezë, përveç Kosovës pjesëmarrës do të jenë edhe vendet tjera të Ballkanit Perëndimor si: Shqipëria (nikoqire), Maqedonia, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia. Po ashtu në Tryezë do të marrin pjesë edhe Bullgaria dhe Rumania, Ambasadori i Komisionit Evropian në Tiranë z. Helmuth Lohan dhe Menaxherja e Sektorit të Arsimit në Bankën Botërore znj. Mamta Murthi.

Takimi do të mbahet me qëllim shkëmbimi të eksperiencave të vendeve të Evropës Juglindore në lidhje me masat antikorrupsion në arsim dhe themelimin e një iniciative të përbashkët të vendeve të EJL për masat antikorrupsion.

Në këtë takimi është paraparë që secili vend pjesëmarrës të paraqesë pikëpamjet e tij në lidhje me masat antikorrupsion. Ndërkaq nga takimi pritet që të themelohet një tryezë regjionale me përfaqësues të ministrive të arsimit të vendeve të Evropës Juglindore për të identifikuar masat dhe për të monitoruar progresin në lidhje me luftimin e korrupsionit, si dhe të identifikohen disa indikatorë në bazë të të cilëve do të përcillet progresi i arritur i vendeve në lidhje me luftimin e korrupsionit.

Po ashtu gjatë këtij takimi do të propozohet themelimi i një Komiteti ose Bordi me anëtar nga secili vend dhe me përfaqësues të Bankës Botërore dhe Bashkimit Evropian. Ky komitet do të propozoj planin e punës, aktivitetet, do të vlerësoj raportet për secilin vend dhe të përgatisë raportin përmbledhës në lidhje me luftimin e korrupsionit në arsim.

Propozohet që secili vend të emëroj koordinatoren në nivel kombëtar që do të komunikoj dhe koordinoj aktivitetet në vend dhe me institucionet ndërkombëtare.

25 tetor 2007

Pas pjesëmarrjes në Tryezën mbi arsimin dhe anitkorrupsionin, Ministri Agim Veliu kthehet në Prishtinë

Veliu: mirëpres nismën për krijimin e një tryeze regjionale për identifikimin dhe monitorimin e progresit në lidhje me masat antikorrupsion

Krahas krijimit të një mjedisi miqësor për nxënësin dhe studentin, duhet të shohim se si të krijojmë një mjedis jomiqësor për korrupsionin. Korrupsioni nuk do të jetë i pranishëm aty ku njerëzit mund t'i realizojnë të drejtat e veta në rrugë ligjore, prandaj është obligim për ne, si institucione, të krijojmë mekanizma që pengojnë kërkimin e rrugëve alternative, tha Ministri Veliu në Tryezën mbi arsimin dhe anitkorrupsionin që u mbajt në Tiranë

Me qëllim të shkëmbimit të përvojave të vendeve të Evropës Juglindore -EJL në lidhje me masat antikorrupsion në arsim si dhe për themelimin e një iniciative të përbashkët të vendeve të EJL për masat antikorrupsion, dje në Tiranë u mbajt Tryeza mbi arsimin dhe anitkorrupsion. Në këtë tryezë përveç Kosovës pjesëmarrës ishin edhe Shqipëria (nikoqire), Maqedonia, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia.

Në këtë tryezë Kosovën e prezantoi Ministri Agim Veliu dhe tha se është i bindur se reformat dhe zhvillimi i arsimit në vendet e Evropës Juglindore mund të shkojnë përpara vetëm me përpjekje të përbashkëta, ngase problemet që ballafaqohemi janë të natyrës së njëjtë, prandaj do të jetë ndihmesë e madhe nëse i adresojmë së bashku, duke ndihmuar njëri-tjetrin në mënyra të ndryshme. Së pari, të gjitha vendet e Evropës Juglindore kanë një të kaluar të përbashkët e cila ka ndikuar në formësimin dhe në përmbajtjen e sistemit arsimor në vendet tona. Së dyti, të gjithë ne po mundohemi të reformojmë sistemin arsimor në përputhje me rrjedhat evropiane në arsim, në mënyrë që vendet tona të jenë pjesë e Shoqërisë së Dijes dhe të kontribuojnë në zhvillimin e kësaj pjese të Kontinentit. Këto dy elemente janë të mjaftueshme për të kuptuar se nevojitet një qasje e përbashkët në zgjidhjen e problemeve ekzistuese dhe në sigurimin e perspektivës evropiane të arsimit në Evropën Juglindore. Ndërkaq, Ministria që unë drejtoj ka për detyrë të ofrojë arsimim cilësor për rreth gjysmë milioni nxënës dhe studentë në të gjitha nivelet. Këta të rinj përbëjnë një të pestën e popullatës sonë dhe i takojnë shtresave të ndryshme sociale dhe komuniteteve të ndryshme etnike. Shpesh kanë nevoja të ndryshme, ndërsa arsimimi luan rol të rëndësishëm në të ardhmen e tyre, tha Ministri Veliu në këtë takim.

Meqë në këtë takim është paraparë që secili vend pjesëmarrës të paraqesë pikëpamjet e tij në lidhje me masat antikorrupsion, Ministri Veliu tha :”Si dhe të gjitha vendet e Rajonit edhe ne i kemi identifikuar format e ndryshme të korrupsionit në arsim, dhe jemi në kërkim të masave për çrrënjosjen e tyre. Kemi nxjerrë akte nënligjore për parandalimin e korrupsionit në institucionet arsimore të cilat parashohin masa konkrete

kundër personave që përfshihen në aktivitete të tilla. Në Kosovë ne kemi themeluar një Agjension për Luftimin e Korrupsionit në të gjitha institucionet e vendit dhe mendoj se kjo është një qasje gjithëpërfshirëse antikorrupsion”.

Ndërsa sa i përket preventivës, Veliu tha: “mendojmë se preventiva më e mirë është rritja e transparencës brenda sistemit të arsimit dhe vetëdijesimi i të gjithë atyre që janë pjesë e sistemit të arsimit – mësime dhënëse, nxënëse, studentëve, administratorëve – që t’i identifikojnë dhe t’i raportojnë format e ndryshme të korrupsionit. Përderisa, për disa forma ekstreme të korrupsionit ekzistojnë masat ligjore, disa të tjera i nënshtrohen vetëm gjyqimit moral të rrethit”. Gjatë këtij prezantimi Veliu shtoi se krahas krijimit të një mjedisi miqësor për nxënësin dhe studentin, duhet të shohim se si të krijojmë një mjedis jomiqësor për korrupsionin. Korrupsioni nuk do të jetë i pranishëm aty ku njerëzit mund t’i realizojnë të drejtat e veta në rrugë ligjore, prandaj është obligim për ne, si institucione, të krijojmë mekanizma që pengojnë kërkimin e rrugëve alternative.

Sa i përket iniciativës që në këtë Tryezë të propozohet themelimi i një Komiteti ose Bordi me anëtar nga secili vend, me përfaqësues të Bankës Botërore dhe Bashkimit Evropian, e që më pas ky komitet të propozoi planin e punës, aktivitetet, të vlerësoi raportet për secilin vend si dhe të përgatisë raportin përmbledhës në lidhje me luftimin e korrupsionit në arsim, Veliu tha se e mirëpret nismën për krijimin e një tryeze regjionale për identifikimin dhe monitorimin e progresit në lidhje me masat antikorrupsion. “Jemi të interesuar të mësojmë nga përvojat e vendeve të tjera, por edhe të sjellim përvojën tonë në këtë fushë. Shpresoj se kjo tryezë do të jetë një mundësi shtesë për të identifikuar rrugët më të përshtatshme për luftimin e korrupsionit në sistemet arsimore të vendeve tona. Mbi të gjitha mendoj se kemi nevojë për rritjen e efikasitetit të funksionimit të sistemit arsimor pasi korrupsioni vjen në shprehje kryesisht për shkak të burokracisë dhe jo efikasitetit të funksionimit të institucioneve. Këtë iniciativë bashkë me aktivitetet tjera duhet t’i kuptojmë si masa të nevojshme drejt integritetit të vendeve tona në Bashkimin Evropian”, tha Veliu.

Ndërkaq sa i përket Ministrisë së Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë të Kosovës, Veliu premtoi se MASHT është e gatshme të marrë mbi vete të gjitha obligimet që dalin nga pjesëmarrja në këtë tryezë, duke vendosur një bashkëpunim të hapur dhe korrekt me të gjitha ministrinë kompetente të vendeve të tjera.

26 tetor 2007

Në Prishtinë po mbahet Seminari rajonal “Barazia në arsim – sfidë për Evropën Juglindore”

Filloi punimet seminari “Barazia në arsim – sfidë për Evropën Juglindore”

Seminari rajonal “Barazia në arsim – sfidë për Evropën Juglindore” tregon se sistemet arsimore të vendeve të rajonit po shërbejnë si prijëse të proceseve integruese rajonale dhe evropiane, tha Ministri Veliu me rastin e fillimit të Seminarit

Sot në hotelin “Grand” ka filluar punimet seminari “Barazia në arsim – sfidë për Evropën Juglindore”, i organizuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) në bashkëpunim me Inicativën për Reformë në Arsim në Evropën Juglindore (ERI SEE). Pjesëmarrës në Seminar janë vendet e ndryshme të rajonit si: Kosovës, Austria, Kroacia, Zvicra, Holanda, Maqedonia etj. Gjatë dy ditëve s'ado të mbahet Seminari do të diskutohet për qasjen evropiane lidhur me barazinë në arsim si dhe sfidat me të cilat ballafaqohet rajoni.

Seminarin “Barazia në arsim – sfidë për Evropën Juglindore”, e hapi Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Agim Veliu, e që njëkohësisht pjesëmarrësve ju uroj mirëseardhje dhe punë të mbarë.

Sa i përket organizimit të Seminarit Ministri Veliu tha se sistemet arsimore të vendeve të rajonit po shërbejnë si prijëse të proceseve integruese rajonale dhe evropiane. Kjo përputhet me orientimet dhe vizionin tonë për përfshirje dhe integrim jo vetëm ndërmjet vendeve të rajonit, por edhe të gjitha grupeve në rrjedhat relevante të shoqërive të vendeve të këtij rajoni. Ndërkaq, përvoja e Kosovës, vazhdoi ministri Veliu, e dëshmon pa asnjë dyshim rëndësinë e arsimit në sigurimin e zhvillimit shoqëror, sigurimin e përfshirjes e të barazisë jo vetëm në arsim por përgjithësisht në shoqëri, si dhe lehtësimin e proceseve integruese nacionale, rajonale e evropiane përmes shkollimit dhe bashkëpunimit në fushën e arsimit. “ Po ta krahasojmë Kosovën e sotme me atë të para disa vitesh do të kuptojmë dallimet e mëdha në zhvillimin njerëzor, infrastrukturë, ekonomi, në raportet brenda dhe jashtë vendit. Këto dallime përbajtjesore janë transformime të mëdha të cilat janë arritur duke iu falënderuar sistemit arsimor. Këto transformime përfshijnë edhe pjesën që nuk shihet në sipërfaqe; flasim këtu për ndryshimin e mendësisë, për tolerancën, vlerat humane, barazinë ndërmjet njerëzve pa dallim gjinie, race, besimi e të tjera”, tha Veliu .

Më tej Ministri përmendi ndihmën e madhe të Bashkësisë Evropiane në rimëkëmbjen e vendit pas konflikteve të viteve të nëntëdhjeta, shkëmbimin e përvojave me vendet e rajonit, aftësimin e mësimitdhënësve, hartimin e planprogremve etj. Ministri përmendi ndihmën e UNICEF, KEDP, Bankës Botërore, GTZ, AER, Swiss Kontaktin të cilët tha se kanë dhënë ndihmesë të madhe për shoqërinë dhe arsimin kosovar. “MASHT, në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë, është duke punuar për përmirësimin e

cilësisë në arsimin e të gjitha niveleve si në mësimdhënie e nxënie, ashtu edhe në kurrikula, në tekste e në infrastrukturën fizike. Përfshirja e komuniteteve pakicë, e komuniteteve Romë Ashkalinj e Egjptas, përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta, përfshirja e grupeve të rrezikuara dhe të kategorive të ndryshme sociale kanë një trajtim prioritar në këtë përballje të re. Kjo për arsye se shoqëria kosovare nuk mund të ecë me kohën e me vendet e tjera pa zhvillimin dhe shfrytëzimin e të gjitha kapaciteteve të saj njerëzore. Kjo është bindje edhe e jona. Ndërkaq, në procesin e nisur do të na ndihmojnë pa dyshim edhe përvojat e mira që do të prezantohen në këtë Seminar, e që vinë nga vende të ndryshme të Evropës, si dhe rezultatet e diskutimeve që do të dalin nga këtu”, theksoi Velju.

Ministri Velju në fund shprehu falënderim për ERI SEE-në për organizmin e Seminarit me një temë kaq të rëndësishme për Kosovën. Ai konfirmoi edhe një herë gatishmërinë e MASHT për të qenë pjesë aktive e proceseve integruese rajonale në fushën e arsimit. Në vazhdim punimet e Seminarit i përshëndetën z. Mihaylo Milovanovitch, nga Ministria Federale e Arsimit, Arteve dhe Kulturës e Austrisë dhe znj. Aspasija Hadzisce, Drejtoreshë e Agjencionit ERI SEE.

Përfaqësues të Iniciativës për reformimin e arsimit në Evropën Juglindore thanë se reforma në arsimin kosovar është një ndër prioritetet e tyre dhe premtuan që këtë prioritet do ta çojnë deri në fund.

Drejtori i Departamentit të arsimit të Lartë në MASHT, z. Nexhmi Rudari tha se Seminari do të vazhdojë me diskutime të përfaqësuesve të vendeve të rajonit edhe ditën e nesërme, me ç'rast do të do të jepen edhe konkluzionet dhe rekomandimet për bashkëpunimin e ardhshëm rajonal.

29 tetor 2007

Delegacioni i mësueseve nga Suedia vizitoi MASHT

Zëvendësministri i MASHT, Fevzi Berisha priti një delegacion të mësueseve suedeze dhe shqiptare nga qyteti Malmo i Suedisë. Të pranishëm nga MASHT ishin edhe sekretari i përhershëm, z. Fehmi Ismili, Dëfrim Gashi, drejtor i departamentit të inspektimit, Nuhi Gashi, zyrtar i mësimit plotësues në diaporë. Ndërsa në delegacionin e mësueseve, të prirë nga mësuesja e gjuhës shqipe për nxënësit shqiptarë znj. Bahtije Ratkoceri, mernin pjesë drejtoresha e shkollës fillore në Malmo, znj. Agneta Christensson, drejtoresha e institucioneve parashkollore, znj. Margaratha Mungendorff dhe mësuese suedeze dhe shqiptare nga Suedia.

Z. Fevzi Berisha pasi i uroi mysafirëve mirëseardhje, theksoi se një vizitë e tillë është shumë e rëndësishme për bashkëpunim të ndërsjellët.

Suedia është vendi që ka përvojat më të mira në arsim dhe është me interes për ne që këto përvoja të shkëmbehen. Ai falenderoi qeverinë Suedeze për mundësimin e mësimin në dy gjuhë për nxënësit shqiptarë.

Në vazhdim zëvendësministri, tha se në Kosovë janë rreth 460.000 nxënës dhe studentë , d.m.th 1\4 e e popullatës është e kuçyr në arsim, ndërsa janë 32.000 të punësuar në sitemin arsimor.

MASHT ka filluar reformimin e sistemit të arsimit menjëherë pas luftës, me sistemin 5+4+3 ose 4. Kemi sistemin e obliguar 9 vjecar, arsimin fillor 5 vjecar, arsimin emesëm të ulët 4 vjecar dhe arsimin e lartë 3 ose 4 vjecar.

Në disa shkolla kemi inkuadruar edhe arsimin gjithëpërfshirës, por ende kemi edhe shkolla të vecanta për arsimin special.

Kemi edhe mësimin për komunitete në gjuhën bosnjake, turke, kroate, prej nivelit parashkollor deri te arsimit i lartë. Tani , theksoi zëvendësministri, jemi në fazën e monitorimit te reformave, për të cilin proces kemi angazhuar edhe dy Institute: Institutin e Lublanës dhe atë të Londrës.

Gjithashtu zëvendësministri përmendi edhe përgatitjen e Strategjisë për Arsimin Parauniversitar 2007-2017 si dhe atë të Arsimit të Lartë 2007-2015.

Znj. Margaratha Mungendorff, theksoi se qyteti Malmo është një vend me shume nacionalitete, përafërsisht 60% e nxënësve kanë një gjuhë tjetër amtare. Nëpër të gjitha shkollat mësimi zhvillohet edhe në gjuhën e tyre amtare dhe për këtë janë angazhuar 28 mësimdhënës. Grupi më i madh i nxënësve është ai që mëson në gjuhën arabe, ndërsa grupi i dytë është në gjuhën shqipe. Arsyeja pse ato shprehen interesim të vizitonin Kosovën, ishte numri i madh i nxënësve që mësojnë në shkollat e Suedisë.

Mësueset ishin të interesuara për sistemin arsimor në Kosovë, për kushtet e nxënësve nëpër shkolla, për reformat në arsim etj. Ato treguan se si zhvillohet mësimi në dy gjuhë dhe cilat janë vështirësitë me të cilat ballafaqohen. Sekretari i përhershëm z. Fehmi Ismili i ofroi mbështetje nga ana e MASHT dhe

theksoi se kjo përvojë e mirë duhet të shërbejë si model në vendet e tjera që nuk kanë traditë në mësimin e dygjuhësisë.

Të dy palët ishin të mendimin që të vazhdohet bashkëpunimi i mëtutjeshëm me qëllim këmbimit të përvojave.

Pas vizitës në MASHT, mësueset do ta vizitojnë shkollën filloore “Elena Gjika” në Prishtinë.

30 tetor 2007

S.P Fehmi Ismaili priti nxënësit pjesëmarrës në Olimpiadën Speciale Botërore e cila u mbajt në Shangaj të Kinës

Nxënësit kosovar kthen me çmime të para nga Olimpiada Speciale Botërore e fëmijëve me aftësi të kufizuara

Në mesin e 7000 pjesëmarrësve nga 170 vende të botës, nxënësit tanë kthehen me një medalje të artë, dy të argjendta dhe dy të bronzta

Sekretari i Përhershëm i MASHT Fehmi Ismaili, i priti katër nxënësit kosovar pjesëmarrës në Olimpiadën Speciale Botërore të garave në atletikë e cila u mbajt në Shangaj të Kinës.

Me rastin e vizitës së që nxënësit i bënë MASHT në shenjë falënderimi për mbështetjen simbolike ata u shprehën se ndjehen të lumtur që patën rast të marrin pjesë në një garë të tillë përmasash botërore dhe po aq krenarë që në këtë garë morrën medalje të arta dhe të argjendta .

Me këtë rast S.P Ismaili tha: “rezultatet e juaja tregojnë se jemi një popull me talent dhe shkathësi të veçanta të cilat me një përkujdesje profesionale premtojnë rezultate kulminante në të gjitha garat sportive por edhe në aktivitetet tjera të ngjashme .

Me këtë rast ju përgëzoj dhe dëshiroj që të keni suksese të mira edhe në mësimet në punë e në jetë”. Ndonëse mundësitë buxhetore të MASHT ishin të kufizuara megjithatë ne kemi bërë krejt çka është e mundur që nxënësit kosovar të jenë pjesëmarrës në këtë garë. Andaj tani ndjehemi krenarë për rezultatet që kanë arritur, tha S.P Ismaili. “Uroj që herëve tjera nxënësit tanë të shkojnë më të përgatitur dhe numerikisht më shumë ashtu që të kemi më shumë mundësi për të arritur rezultatet edhe më të mira”, tha Ismaili. Ndërkaq, udhëheqësja e grupit znj Valbona Gashi, kryetare e OJQ Olimpiada Speciale në Kosovë, tha se ishte e kënaqur me përkujdesjen e mikpritjen dhe rezultatet e arritura nga nxënësit tanë.

“Na mungoj përvoja, ndryshe do të kishim rezultate me të mira“, tha znj Gashi. Më pas znj Gashi falënderoi MASHT për mbështetjen dhe ndihmesën që ka dhënë për këta nxënës.

Olimpiada Speciale Botërore e garave në atletikë organizohet çdo katër vite dhe në të marrin pjesë nxënës (fëmijë) me aftësi të kufizuara. Sivjet në këtë garë morën pjesë

rreth 7000 garues nga 170 vende të botës. Nga Kosova morën pjesë :Pajtim Maloku nxënës i klasës së 9 të shkollës “Përparimi “të Prishtinës, është fitues i garës vrapim në 400 m dhe është stolisur me medaljen e artë. Pajtimi ka marrë edhe medaljen e bronzte në garën 100 metra. Agron Munishi nxënës i shkollës Lef Nosi të Prizrenit ka marrë medaljen e argjendtë në vrapimin në 100 metra. Ndërsa atë të Bronztën në vrapim 400 metra. Pjesëmarrëse në këtë garë ishte edhe Arta Avdyli nxënëse e shkollës “Përparimi” të Prishtinës dhe Mirsad Gashi nxënësi i shkollës “Nëna Tereze “ Mitrovicë të cilët u radhitën ndër dhjetë të parët .

Trajnere e grupi të nxënësve tanë sportistë ishte znj. Kimete Beka, prof. e Edukatës Fizike, e cila tha se ndjehem krenare për rezultatet e arritura në një konkurrencë të fortë, ndërkaq tani kemi fituar një përvojë dhe sikur të kemi edhe ndonjë rast tjetër do të arrijmë rezultate edhe më të mira tha znj. Beka.